

# Diaspora e Shqipërisë në Shifra

---

INSTAT, 2018



# Përmbajtja

---

Hyrje.....	3
1. Metodologjia.....	3
1.1 Metodologjia e përlogaritjes së diasporës së re shqiptare.....	3
1.2 Kufizimet në metodologjinë e përlogaritjes së diasporës shqiptare.....	4
1.3 Rekomandime për të ardhmen .....	5
1.4 Përkufizime.....	5
2. Vlerësimi i Diasporës shqiptare .....	6
2.1 Vlerësimi i diasporës – metoda e tërthortë.....	7
3. Shqiptarët në botë - Stoku i emigracionit shqiptar .....	9
3.1 Diaspora shqiptare - historik.....	9
3.2 Censet ndërkombëtare – shqiptarë të regjistruar .....	11
3.2.1 Profili i shqiptarëve në Europë – të dhënat nga Censet.....	12
3.2.1.1 Karakteristikat demografike .....	13
3.2.1.2 Statusi në punësim .....	13
3.2.2 Diaspora shqiptare në SHBA.....	15
3.2.3 Profili i shqiptarëve në SHBA.....	16
3.2.3.1 Karakteristikat demografike .....	16
3.2.3.2 Karakteristikat arsimore .....	17
3.2.3.3 Statusi në punësim .....	17
4. Emigracioni dhe karakteristikat e tij - Flukset migratore .....	17
4.1 Impakti në dinamikën e popullsisë .....	18
5. Referenca.....	21

## Hyrje

Migrimi i shqiptarëve jashtë vendit nuk është një dukuri e re. Ajo është e dokumentuar të paktën që në shekujt e pesëmbëdhjetë dhe të gjashtëmbëdhjetë me largimin e një mase të madhe banorësh të trevave shqiptare. Ai vazhdon ende të mbetet veprues dhe të japë impaktet e tij domethënëse si në aspektet demografike po ashtu edhe ato sociale dhe ekonomike të vendit. Periudhat kohore të formimit të diasporës shqiptare ndryshojnë.

E ashtuquajtura "diaspora e vjetër" përbëhet nga emigrantë që kanë emigruar para vitit 1944, të cilët konsiderohen diasporë shumë e hershme si dhe nga ata që u larguan gjatë viteve 1945-1990 dhe që përkon kryesisht me shqiptarët në ish-Jugosllavi. Ndërsa "diaspora e re" përbëhet nga emigrantët që kanë emigruar pas viteve 1990 e cila përkon me valën e madhe të migrimit pas rënies së komunizmit. Diaspora e vjetër ka qenë e vendosur kryesisht në SHBA dhe disa vende të Evropës Perëndimore, ndërsa diaspora e re është vendosur në Greqi, Itali, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Zvicër, Francë etj. dhe më pak në vendet të diasporës së vjetër.

Ende nuk përlllogaritet një shifër e saktë e diasporës shqiptare për shkak të kompleksitetit që e karakterizon këtë fenomen. Megjithatë sipas vlerësimeve të tërthorta në vitin 2018, numri i diasporës së re llogaritet të jetë rreth 1.6 milionë shtetas jashtë vendit ose rreth 36 përqind të shtetasve shqiptar gjithsej.

Ky publikim kryhet për herë të parë nga INSTAT në kuadër të Strategjisë së Diasporës. Qëllimi i tij është vlerësimi i numrit të diasporës shqiptare dhe profilit e saj mbi karakteristikat bazë demografike dhe sociale. INSTAT do të vazhdojë bashkëpunimin me institucionet partnere të vendeve pritëse të diasporës shqiptare në vijim për të arritur në statistika edhe më gjithëpërfshirëse.

## 1. Metodologjia

### 1.1 Metodologjia e përlllogaritjes së diasporës së re shqiptare

Duke pasur parasysh se shqiptarët vendbanues nuk regjistrohen sistematikisht kur largohen nga vendi dhe duke qenë se ka pak stimuj që ata të regjistrojnë largimin te autoritetet vendore, nuk ka matje të besueshme të numrit të individëve që janë larguar nga Shqipëria. Sidoqoftë, INSTAT përdor metoda të tërthorta për kryerjen e një vlerësimi mbi numrin e migrantëve i cili bazohet në të dhënat e dy censeve të njëpasnjëshëm. Censi i popullsisë dhe banesave në Shqipëri jep një vlerësim të stokut të migracionit brenda periudhës midis censeve. Siç dihet duke përdorur Censet për matjen e migracionit ka vështirësi ose kufizime. Censi i Popullsisë dhe Banesave kryhet çdo

10 vjet, përmban vetëm një numër të vogël pyetjesh dhe nuk mund të numërojë të gjitha ngjarjet e migrimit si familje të tëra që lëvizin, migrimin sezonal/të përkohshëm dhe qarkullues.

Metoda e thërthortë që INSTAT përdori për një derivim të numrit të përgjithshëm të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit si dhe strukturën e tyre moshore dhe gjinore, ishte krahasimi i dy popullsive, asaj të popullsisë banuese dhe regjistrit civil. Si bazë u morë popullsia më 1 janar 2018 e regjistrit civil, e cila përmban të gjithë shtetasit shqiptarë pavarësisht vendbanimit të tyre (edhe ata që jetojnë jashtë vendit) sipas moshës dhe gjinisë. Kësaj popullsie ju zbrit popullsia e përlllogaritur nga INSTAT (estimim vjetor), e cila i referohet popullsisë banuese në vend (personat që plotësojnë kushtin e vendbanuesit të zakonshëm- që jetojnë në vend për 12 muaj ose më shumë). Në këtë mënyrë u përlllogarit numri i diasporës së re shqiptare në 1 janar 2018.

## 1.2 Kufizimet në metodologjinë e përlllogaritjes së diasporës shqiptare

Sipas metodës së thërthortë të prezantuar më sipër u mundësua një vlerësim i pjesshëm i diasporës shqiptare. Kjo metodë, mund të themi se ka mundësuar pothuajse një mbulim të plotë të diasporës së re, por nuk ka mbuluar diasporën e hershme, thënë ndryshe pasardhësit e shqiptarëve të larguar nga Shqipëria para viteve 1990. Kjo përlllogaritje merr parasysh të gjithë shtetasit shqiptar që figurojnë të regjistruar në regjistrin civil pavarësisht se jetojnë jashtë vendit, personat të cilët janë diasporë shqiptare por nuk kanë një shtetësi shqiptare, pra nuk figurojnë në regjistrin civil nuk janë pjesë e përlllogaritjeve.

Më poshtë janë kufizimet që kjo metodë ka në përlllogaritjen e diasporës shqiptare janë:

- Nëpërmjet regjistrit të DPGJC nuk janë të përfshirë shqiptarët të cilët për arsytet të fitimit të një shtetësie të një vendi tjetër kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare. Ka disa vende të cilat nuk e lejojnë dy-shtetësinë dhe për këtë arsye shtetasit shqiptarë janë të detyruar të heqin dorë nga shtetësia shqiptare, në këtë mënyrë këta individë çregjistrohen nga regjistri i shtetasve shqiptarë.
- Lindjet të cilat ndodhin jashtë vendit dhe janë të regjistruara në regjistrin e gjendjes civile janë të përfshira në përlllogaritjet e kryera nga INSTAT, ndërkohë lindjet të cilat nuk regjistrohen në zyrat e gjendjes civile nuk janë pjesë e përlllogaritjeve.
- Komunitetet e hershme shqiptare në botë, të cilë kanë lindur jashtë kufijve të Shqipërisë, mbajnë lidhje gjuhësore, kulturore e të traditës në vazhdimësi dhe që ka dëshirë të ruajnë lidhjet me Shqipërinë, nuk janë pjesë e përlllogaritjeve të INSTAT.

### 1.3 Rekomandime për të ardhmen

Vendet të cilat kanë si qëllim përfshirjen e diasporës së tyre në zhvillimin e vendit, nuk ju mjafton vetëm numri i tyre, por shumë i rëndësishëm është profili i tyre si demografik ashtu dhe social e ekonomik, më specifikisht përqëndrimin e tyre, statusin arsimor dhe atë në punësim. Këto karakteristika do të ndihmojnë më së shumti qeverinë për të kuptuar më qartë potencialin profesional dhe ekonomik që ka diaspora.

Këto përllogaritje duhen komplementuar në vijim me burime të tjera të dhënash në mënyrë që të sigurojnë një pamje të plotë të diasporës shqiptare jo vetëm si madhësi por edhe një profil social dhe ekonomik të tyre.

Ndërtimi i regjistrit të emigrantëve, nismë e ndërmarrë tashmë nga Ministria e Brendshme do të ndihmonte shumë në këtë drejtim.

Përpjekje do të bëhen edhe nga Ministria e Europës dhe Punëve të Jashtme, për mbledhjen e të dhënave cilësore nga Përfaqësitë Diplomatike.

### 1.4 Përkufizime

**Diaspora** përfshin: a) komunitetet e hershme shqiptare në botë; b) çdo person, i cili është lindur në Shqipëri dhe jeton jashtë kufijve të saj; c) çdo person që gëzon origjinë shqiptare, i cili ka lindur jashtë kufijve të Shqipërisë, mban lidhje gjuhësore, kulturore e të traditës në vazhdimësi dhe që ka dëshirë të ruajë lidhjet me Shqipërinë.

**Diaspora e vjetër** përbëhet nga emigrantë që kanë emigruar para vitit 1944, të cilët konsiderohen diasporë shumë e hershme si dhe nga ata që u larguan gjatë viteve 1945-1990 dhe që përkon kryesisht me shqiptarët në ish-Jugosllavi.

**Diaspora e re** përbëhet nga emigrantët që kanë emigruar pas viteve 1990 e cila përkon me valën e madhe të migrimit pas rënies së komunizmit.

**Shtetësia** shqiptare është një lidhje e qëndrueshme juridike, që shprehet në të drejtat dhe detyrat e në ndërsjellta të personit fizik dhe të shtetit shqiptar. Shtetësia shqiptare fitohet, rifitohet, humbet apo lihet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili respekton normat e parimet e njohura të së drejtës ndërkombëtare në fushën e shtetësisë të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

**Vendi i lindjes** është vendi në të cilin ka ndodhur lindja e një personi.

## 2. Vlerësimi i Diasporës shqiptare

Migracioni vazhdon të jetë një çështje e rëndësishme për shumë vende në botë, duke ndikuar si vendet origjinë ashtu edhe ato destinacion. Shumë pak dihet për numrin vjetor aktual të migrantëve në të gjithë botën dhe informacioni i pakët i disponueshëm është kontradiktor. Sot, vendet bazohen në definicionet e tyre se çfarë nënkuptohet me ‘migracion’. Kjo krijon inkonsistenca për të dhënat ndërkombëtare dhe është sfidë për të kuptuar procesin me anë të të cilit personat lëvizin përtej kufijëve.

Shpesh është theksuar se informacioni statistikor mbi migracionin është i pamjaftueshëm dhe jo i plotë sa i përket disponueshmërisë, harmonizimit të koncepteve, definicioneve dhe saktësisë. Është gjerësisht e njohur se të dhënat e migrimit nuk janë të lehta për t'u mbledhur dhe se sistemet e mbledhjes së të dhënave, si dhe përkufizimet e përdorura për të përcaktuar ngjarjet e migrimit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme.

Kështu, të dhëna konsistente lidhur me flukset migratore janë të nevojshme për një sërë arsyesh të cilat janë kritike për zhvillimin e një evidence të besueshme mbi politikat e migracionit dhe kërkimet. Një nga vështirësitë kryesore është mungesa e një definicioni standard për matjen e flukseve migratore. Gjithashtu e nevojshme është që të dhënat të shkëmbehen midis vendeve origjin dhe destinacion, si dhe të përgatiten procedurat për vlerësimin e flukseve migratore të raportuara.

Në rastin shqiptar, matja e flukseve të migracionit është sfida kryesore. Të vetmet të dhëna në dispozicion në lidhje me migrimin ishin censi i popullsisë dhe banesave në Shqipëri, i cili jep një vlerësim në lidhje me stokun e migracionit brenda periudhës midis censeve. Siç dihet duke përdorur Censet për matjen e migracionit ka vështirësi ose kufizime. Censi i Popullsisë dhe Banesave kryhet çdo 10 vjet, përmban vetëm një numër të vogël pyetjesh dhe nuk mund të numërojë të gjitha ngjarjet e migrimit si familje të tëra që lëvizin, migrimin sezonal/të përkohshëm dhe qarkullues.

Megjithatë INSTAT shpesh herë përdor metoda të thërthorta për matjen e këtij fenomeni kompleks, në mënyrë që të arrijë në një vlerësim të përafërt të numrit të përgjithshëm, stokut të migracionit. Pavarësisht se këto metoda nuk mund të na japin një pamje të plotë duke na siguruar një profil të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit, të paktën na sigurojnë një paraqitje të strukturës së tyre moshore dhe gjinore.

## 2.1 Vlerësimi i diasporës – metoda e tërthortë

Një nga metodat e tërthorta që INSTAT përdori për një derivim të numrit të përgjithshëm të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit si dhe strukturën e tyre moshore dhe gjinore, ishte krahasimi i dy popullsive asaj të popullsisë banuese dhe regjistrit civil. Si bazë u mor popullsia më 1 janar 2018 e regjistrit civil, e cila përmban të gjithë shtetasit shqiptarë pavarësisht vendbanimit të tyre (edhe ata që jetojnë jashtë vendit) sipas moshës dhe gjinisë. Kësaj popullsie ju zbrit popullsia e përlogaritur nga INSTAT (përlogaritje vjetore), e cila i referohet popullsisë banuese në vend (personat që plotësojnë kushtin e vendbanuesit të zakonshëm- që jetojnë në vend për 12 muaj ose më shumë). Në këtë mënyrë u përftua një estimim i shtetasve shqiptarë që nuk jetojnë në vend në 1 janar 2018.


Diaspora e vlerësuar nga INSTAT përlogaritet 1,584,137 individë jashtë territorit të Shqipërisë, ku 828,530 individë janë meshkuj dhe 755,607 janë femra.

<b>1 Janar 2018</b>			
<b>Grupmosha</b>	<b>Meshkuj</b>	<b>Femra</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>0-4</b>	37,854	33,219	71,073
<b>5-9</b>	58,248	50,391	108,638
<b>10-14</b>	57,350	50,715	108,064
<b>15-19</b>	55,401	45,041	100,442
<b>20-24</b>	63,168	54,424	117,592
<b>25-29</b>	78,302	76,537	154,838
<b>30-34</b>	84,332	88,791	173,123
<b>35-39</b>	87,368	83,557	170,925
<b>40-44</b>	81,884	73,161	155,045
<b>45-49</b>	72,004	60,944	132,948
<b>50-54</b>	51,100	41,324	92,424
<b>55-59</b>	39,252	33,403	72,655
<b>60-64</b>	25,910	19,996	45,906
<b>65-69</b>	15,519	13,621	29,140
<b>70-74</b>	6,810	6,533	13,343
<b>75-79</b>	3,669	6,761	10,430
<b>80-84</b>	4,386	5,083	9,469
<b>85+</b>	5,975	12,107	18,082
<b>Gjithsej</b>	<b>828,530</b>	<b>755,607</b>	<b>1,584,137</b>


Sic edhe përlllogaritjet tregojnë ajo përfshin një popullsi relativisht të re. Pikërisht thellimet që vihen re në piramidën e popullsisë banuese, janë reflektim i strukturës së popullsisë së diasporës. Më ooshtë prezantohen dy piramida popullsie: (a) prezanton krahasimin e popullsisë banuese dhe diasporës, ndërsa (b) prezanton piramidën e popullsisë së shtetasve shqiptar gjithsej dhe atë të diasporës.

### Piramida e Popullsisë

(a) Popullsia banuese dhe popullsia e shtetasve shqiptar



(b) Diaspora





Raporti i varësisë së të rinjve përse i përket diasporës shqiptare përllongarit 23.7 %, cili rezulton më i ulët se ai i popullsisë banuese në 2017 (26,0%). Raporti i varësisë së të moshuarve 6,6 % është shumë më i ulët se ai i popullsisë banuese i cili në vitin 2017 shënon vlerën 19,4%. Raporti gjinor i popullsisë së diasporës përllongarit 109.7 meshkuj për 100 femra. Mosha medianë e popullsisë së diasporës rezulton 32 vjeç, e cila mbështet dhe faktin që emigracioni shqiptar involvon një popullsi të re dhe se diaspora shqiptare është më e re në moshë sesa popullsia banuese në Shqipëri, ku mosha medianë gjatë vitit 2017 shënoi vlerën 35 vjeç.

Raporti i varësisë së të rinjve	23.7%
Raporti i varësisë së të moshuarve	6.6%
Raporti i varësisë total	30.3%
Raporti gjinor	109.7
Mosha median	32

### 3. Shqiptarët në botë - Stoku i emigracionit shqiptar

#### 3.1 Diaspora shqiptare - historik<sup>1</sup>

Historiku i Diasporës shqiptare është i hershëm. Vetë pozita e vendit ku jetojnë shqiptarët, është e tillë që i bën ata të lëvizin në drejtime të ndryshme. Diaspora shqiptare është heterogjene në dy pikëpamje, të kohës së mërgimit si dhe në pikëpamje të regjionit prej nga kanë ardhur. Duke analizuar aspektin kohor, bashkësitë më të vjetra shqiptare përbëhen nga arbëreshët në Itali dhe arvanitët në Greqi. Të parët kanë arritur që për shekuj të ruajnë idenitetin e tyre, kurse të dytët, janë në fazën përfundimtare të asimilimit të plotë, edhe pse mbase ka shpresë që edhe kjo bashkësi të njohë një ringjallje sado të vogël. Në radhën e këtyre bashkësive të vjetra mund të hyjë pa mëdyshje edhe bashkësia shqiptare e Egjiptit. Pas këtyre vijnë bashkësitë shqiptare në Turqi, SHBA, Belgjikë, Australi e në ndonjë vend tjetër. Të fundit vijnë mërgimtarët e katër dekadave të gjysmës së dytë të shek. XX. Shumica e tyre janë vendosur apo bëjnë përpjekje të vendosen në shtetet e ndryshme të Evropës Perëndimore, në SHBA dhe Kanada. Këtu vlen të përmendim edhe 500 mijë qytetarë të Shqipërisë, të cilët në fillim të viteve nëntëdhjetë, pas hapjes së Shqipërisë ndaj botës, u shpërgulën në Greqi, Itali si dhe në vende të tjera evropiane.

<sup>1</sup> Burimi: <http://www.diaspora.gov.al/diaspora-e-vjeter-shqiptare-ne-bote-2/>

### *Arbëreshët e Italisë*

Arbëreshët e Italisë paraqesin diasporën tonë më të vjetër, por ndoshta edhe më besnike, e cila ruajti traditat kombëtare brez pas brezi për pesë shekuj me radhë. Është e vështirë të dihet se cili është numri i vërtetë i arbëreshëve që jetojnë sot në Itali. Mirëpo, sipas disa të dhënave, pas vdekjes së Skënderbeut, nga Shqipëria në Itali u shpërngulën 200.000 shqiptarë, të cilët u vendosën në Italinë Jugore, ku tani në Kalabri gjenden 180.000 arbëreshë të vendosur në 43 fshatra, dhe në Sicili 120.000 arbëreshë të vendosur në 36 fshatra.

### *Shqiptarët e Egjiptit*

Në Egjipt që nga fillimi i shekullit XVIII, me vendosjen e Mehmet Ali pashës si vali i Egjiptit, numri i shqiptarëve atje ishte rritur vazhdimisht. Dinastia shqiptare e Mehmet Ali pashës kishte sunduar vendin e faraonëve për 150 vjet, nga viti 1805 deri më 1952. Meqenëse shumica e tyre ishin ushtarë, ata ishin shpërndarë edhe nëpër vise të tjera, si në Palestinë, Siri, Liban, Libi, Hixhaz, Jemen e Sudan. Këtë më së miri e vërtetojnë pasardhësit e shumë familjeve me origjinë shqiptare që jetojnë sot atje me mbiemrin Arnauti ose El-Albani.

### *Shqiptarët e Turqisë*

Nuk ka dyshim se numri më i madh i shqiptarëve në periudha të ndryshme kohore është shpërngulur në Turqi. Shqiptarët në Turqi u vendosën në Stamboll, Izmir, Bursë, Manisë, Ajdin, Çanakala, Adapazar, Ankara, Kajser, Qemajl – Pasha, Bafër etj. edhe në 300 fshatra të Anadollit. Ata tejkalojnë numrin 1.500.000. Nëse llogaritet shtimi i tyre natyror, numri i tyre sot duhej të arrinte në 6.200.000.

### *Shqiptarët e Amerikës*

Numri i shqiptarëve të diasporës është rritur, sidomos vitet e fundit, megjithëse shifra të sakta nuk ka dhe nuk kanë për t'u gjendur kurrë, për arsye se një pjesë e madhe e tyre kanë hyrë me pasaporta jugosllave, turke, greke, dhe në statistikat e INS (Zyrës së Imigracionit) figurojnë si të tillë. Kjo bën që regjistrimi i shqiptarëve të jetë gati i pamundur në këtë hapësirë.

### *Shqiptarët në Evropë*

Këtu nuk duhet harruar as diaspora shqiptare në shtetet e Evropës Perëndimore, e vendosur atje në vitet gjashtëdhjetë e shtatëdhjetë të shekullit të kaluar për të gjetur punë. Me kalimin e kohës dhe me keqësimin e situatës në trojet shqiptare, ata morën dhe familjet e tyre. Kjo bëri që ata të mendojnë për një qëndrim më të gjatë në ato vende, ndërsa brezi i dytë për qëndrim të përhershëm. Shumica e emigrantëve në vendet e Evropës Perëndimore janë nga Kosova, Maqedonia, Presheva dhe Mali i Zi.

### 3.2 Censet ndërkombëtare – shqiptarë të regjistruar

Të dhëna nga Eurostat dhe Institutet e Statistikave të vendeve të tjera ndihmojnë për ilustrim në lidhje me destinacionet më të rëndësishme europiane. Sipas këtyre burimeve, rreth 988 mijë shtetas shqiptarë jetojnë jashtë vendit në vitin 2011, popullsia e gjashtë e huaj në BE sipas madhësisë (Eurostat 2011 dhe të dhënat nga IKS) dhe popullsia e tretë më e madhe e shtetasve jo të BE-së (pas turqve dhe marokenëve). Nëse i shtojmë këtyre shifrave të dhënat e shqiptarëve të lindur në Kanada, Australi dhe në Shtetet e Bashkuara, shifra arrin 1 milion, që nënkupton se një në katër shqiptarë jeton jashtë vendit.

Gjatë Censit 2011, Italia dhe Greqia kishin përqindjen më të madhe të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit (mbi 80 përqind). Ato ndiqen nga SHBA, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Kanadaja, Belgjika, Franca, Australia, Spanja dhe Austria.

Duhet të theksohet se shtetësia është një karakteristikë e ndryshueshme, njerëzit mund të fitojnë shtetësinë e vendit të huaj të qëndrimit të tyre. Gjatë viteve 2008-2009, 22.8 mijë shqiptarë kanë fituar shtetësinë greke; në Itali 14 mijë shqiptarë kanë fituar shtetësinë italiane. Kështu së bashku me një numër të panjohur të shqiptarëve të paregjistruar, popullsia e shqiptarëve jashtë vendit do të ishte më e madhe sesa një milion. Nga ana tjetër, popullsia me shtetësi shqiptare jashtë vendit përfshin një brez të dytë të fëmijëve të lindur jashtë Shqipërisë, të cilët nuk duhet të konsiderohen emigrantë.

Vendbanimi	Viti	Numri (në mijë)
<b>Shtetësi Shqiptare</b>		
Greqi	2011	480.8
Itali	2011	482.6
Gjermani	2011	10.5
Mbretëri e bashkuar	2005	10.5
Belgjikë	2011	5.2
Francë	2005	5
Spanjë	2011	1.6
Austri	2009	1.5
<b>Lindur në Shqipëri</b>		
SHBA	2010	77.4
Kanada	2006	7.5
Australi	2006	2.0

Burimi: Eurostat dhe Institutet Kombëtare të Statistikave

### 3.2.1 Profili i shqiptarëve në Europë – të dhënat nga Censet

Të dhënat e censeve të fundit të popullsisë dhe banesave, raundi 2010, tregojnë se 905 mijë individë të lindur në Shqipëri kanë qenë residentë të zakonshëm në 28 vende të Europës nga ana tjetër statistikisht që lidhen me shtetësinë tregojnë se 962 mijë shtetas shqiptarë jetojnë në 15 vende të Europës. Vendet që numërojnë një numër të lartë shtetasish shqiptar si dhe rezidentë të lindur në Shqipëri janë: Greqia, Italia, Gjermani dhe Britania e Madhe.

#### Shqiptarë vendbanues në BE

Europë	Lindur në Shqipëri	Shtetas shqiptar
Belgjikë	7 574	5 251
Bullgari	1 134	269
Republika Çeke	374	-
Danimarkë	264	230
Gjermani	14 490	8 400
Estoni	6	-
Irland	823	768
Greqi	452 553	480 851
Spanjë	2 195	-
Francë	6 905	5 231
Kroaci	175	237
Itali	396 540	451 437
Qipro	275	-
Letoni	9	-
Luksemburg	480	367
Hungari	184	-
Maltë	75	-
Austri	2 732	1 581
Poloni	172	215
Portugali	57	-
Rumani	430	-
Slloveni	144	-
Sllovaki	55	-
Suedi	1 378	671
Britania e Madhe	13 665	5 785
Island	32	-
Norvegji	496	311
Svicër	1 381	-

Burimi: Eurostat, Census Hub


### 3.2.1.1 Karakteristikat demografike

Emigrimi në dekadën e fundit ishte 56 përqind meshkuj në Gjermani dhe Greqi, dhe 51 përqind meshkuj në Itali. Migrimi në Gjermani akoma ka të ngjarë të jetë i lidhur ngushtë me punësimin (dhe studimin) e cila tregohet nga raporti i ulët e fëmijëve. Në krahasim me të, Italia dhe veçanërisht Greqia kanë një shpërndarje moshore më të gjerë, treguese e migrimit familjar. Këto shpërndarje moshore të emigrimit reflektohen tek të dhënat në strukturën e popullsisë së Shqipërisë që aktualisht jeton jashtë vendit siç raportohet në Censin 2011. Struktura moshore e shtetasve Shqiptarë të regjistruar në Censin Italian 2011 gjithashtu tregon qartë efektet e bashkimit familjar si dhe prezencën e një brezi të dytë: fëmijët e emigrantëve shqiptarë të lindur në Itali.

Sipas të dhënave të raundit të censeve 2010, shtetas shqiptarë që jetojnë në Europë figurojnë të jenë të një moshe të re. Rreth 36% e tyre i përkasin grupmoshës 30-49 vjeç. Shifrat tregojnë se janë femrat ato që dominojnë për grupmoshat nën 15 vjeç dhe 15-29 vjeç, ndërsa meshkujt janë më të shumtë në numër në grupmoshën 30-49 vjeç (38,6%).

Këtë fakt e mbështesin edhe raportet e varësisë të cilat sipas të dhënave të censeve tregojnë se janë raporti i varësisë së shtetasve të rinj shqiptar 0-14 vjeç ndaj popullsisë 15-64 vjeç është 32.1% ndërsa ai i shtetasve të moshuar shqiptar 65+ është 5.3 %.

**Shqiptarët rezidentë në Europë**




<b>Gjithsej</b>	
Raporti i varësisë së të rinjve	32.1
Raporti i varësisë së të moshuarve	5.3
Raporti i varësisë gjithsej	37.4

### 3.2.1.2 Statusi në punësim


Referuar të dhënave të censeve të vendeve europiane destinacion të emigrantëve shqiptar, tregojnë se rreth 39.0% e shtetasve shqiptar janë të punësuar, 10.1% të papunë dhe pjesa tjetër inaktivë.

### Statusi i punësimit, gjithsej




Situata ndryshon nëse gjykojmë sipas gjinisë, janë meshkuj ata që karakterizohen me një normë më të lartë punësimi sesa femrat. Sipas fotografisë së censit 2011 në vendet europiane destinacion të shqiptarëve, 51.6% e shtetasve shqiptar meshkuj figurojnë të punësuar, kundrejt 24.9% të femrave shqiptare. Pra, vihet re një hendek gjinor relativisht i konsiderueshëm në shkallën e punësimit, me shkallë më të lartë punësimi për meshkujt se sa për femra.

### Statusi i punësimit, meshkuj




### Statusi i punësimit, femra



Nëse do të analizojmë shpërndarjen e statusit të punësimit sipas shteteve, do të vinim re se një përqindje e lartë e shqiptarëve meshkuj me një status në punësim “i punësuar” vihet re në Mbretërinë e Bashkuar, ndjekur nga Norvegjia dhe Danimarka. Përsa i përket shtetasve të punësuar femra ato shënojnë përqindjen më të lartë në Poloni.

## Shtetasit shqiptar të punësuar



Burimi: Census Hub

### 3.2.2 Diaspora shqiptare në SHBA

Komunitetet shqiptare janë të konsiderueshëm edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ato mund ti ndajmë në dy grupe të mëdha si diasporë e re (individë lindur në Shqipëri dhe të vendosur në SHBA pas viteve 1990) dhe diasporë e hershme (individë të cilët janë pasardhës të shtetasve shqiptarë të vendosur në SHBA pas luftës së dytë botërore). Ndarë në këto dy grupe, sipas anketës së Komunitetit Amerikan 2012, anketë e administruar nga Census Bureau e SHBA, rezulton se 86.600 janë shqiptarë të diasporës së re dhe 127.700 shqiptarë të diasporës së

hershme. Pra një total prej 214.300 shqiptarë që jetojnë në SHBA. Megjithatë komuniteti shqiptar në SHBA ka mundësi të jetë më i madh sesa rezulton nga kjo anketë.

Komunitetet shqiptare në SHBA	
Diaspora e re	Diaspora e hershme
86.600	127.700

Burimi: Anketa e komunitetit Amerikan, 2012

Komunitetet shqiptare në SHBA, janë të përqëndruar në pak vende. Rreth 60.000 shqiptarë janë të përqëndruar në New York duke përbërë në këtë mënyrë komunitetin më të madh. Rreth 43.300 jetojnë në Michigan, 21.300 në Massachusetts, 15.300 në Illinois dh rreth 12.000 në Connecticut. Në shumicën e shteteve të përmendura diaspora e hershme e tejkalon atë të re. Përrjashtime bëjnë Pennsylvania, Maryland and Ohio ku diaspora e re e tejkalon atë të hershme, ndërsa në Virginia, Wisconsin dhe Colorado të dy llojet e diasporave shqiptare janë pothuajse të njëjta në numër.

Referuar tre destinacioneve kryesore të komuniteteve shqiptare si New York, Michigan dhe Massachusetts të cilat numërojnë rreth 58% të shqiptarëve, Michigan përmban shqiptarët më të rinj me një moshë mesatare prej 29 dhe atë median prej 26. Më pas vjen New York me shqiptarët me një moshe mesatare prej 33 dhe ate median prej 31, duke u ndjekur më pas nga Massachusetts ku shqiptarët resident janë të një moshe mesatare dhe median prej 39 vjeç.

Shumica e diasporës (94%) së re emigruan drejt SHBA-ve rreth viteve 1990 dhe 2000, rreth 36% emigruan gjatë viteve 1990 dhe 47% rreth viteve 2000.

Diaspora e hershme përbëhet nga emigrantë shqiptarë të cilët u vendosën në SHBA para dhe pas luftës së dytë botrore. Shqiptarët e parë shkuan në SHBA si punëtorë gjatë fundit të shekullit 19. Komunitete shqiptare të rëndësishëm në SHBA u ndërtuan kryesisht gjatë viteve 1920 dhe 1930 ku familje të plota nga jugu i vendit emigruan drejt SHBA-ve.

### 3.2.3 Profili i shqiptarëve në SHBA

#### 3.2.3.1 Karakteristikat demografike

Diaspora e re në SHBA është më e vjetër në moshë sesa ajo e hershme, respektivisht me një moshe mesatare 40 dhe 29 vjec. Diaspora e re në fakt është më numeroze në grupmoshën 25-54



vjec dhe kjo lidhet kryesisht edhe me arsyet e emigrimit të tyre në SHBA - studim apo për arsye punësimi. Nga ana tjetër diaspora e hershme i takon më së shumti gjeneratave të shqiptarëve të vendosur kohë më parë në SHBA, dhe si rrjedhim ata janë fëmijë dhe të rinj.

	Mosha mesatare	% meshkujve
Diaspora e re	39.8	52.7
Diaspora e hershme	29.3	51.7

Burimi: Anketa e komunitetit Amerikan, 2012

Referuar gjinisë, 53% e shqiptarëve të diasporës së re janë meshkuj ndërsa në diasporën e hershme 52% .

### 3.2.3.2 Karakteristikat arsimore

Nëse do të analizojnë karakteristikat arsimore, 32% e shqiptarëve të diasporës së re të moshës mbi 25 vjec kanë një diplomë bachelor, ndërsa vetëm 26.5% e shqiptarëve të diasporës së hershme kanë një të tillë. Të dhënat sipas anketës tregojnë se shqiptarët e diasporës së re janë më mirë të arsimuar sesa ata të diasporës së vjetër.

### 3.2.3.3 Statusi në punësimin

Përsa i përket karakteristikave të tyre ekonomike, dhe specifiku statusit në punësim, të dy llojet e diasporave kategorizohen kënaqshëm referuar normave të tyre të punësimin. Megjithatë diaspora e re, si rezultat i përbërjes së saj moshore ka normë pjesëmarrjeje në tregun e punës më të lartë se diaspora e hershme. Ndërsa referuar normave të vet-punësimin është diaspora e e hershme ajo që dominon krahasuar me atë të re.

	Diaspora e re	Diaspora e hershme
Norma e papunësisë	8.8%	8.9%
Pjesëmarrja në forcën e punës	71.0%	60.7%
Norma e vet-punësimin	9.6%	11.6%

Burimi: Anketa e komunitetit Amerikan, 2012

## 4. Emigracioni dhe karakteristikat e tij - Flukset migratore

Migrimi ndërkombëtar ka qenë një forcë e madhe në ndryshimin e popullsisë në dy dekadat e fundit. Arsyeja kryesore për rënien e popullsisë në dy Censet e fundit ishte emigrimi në shkallë

të gjerë i qytetarëve shqiptarë. Në Shqipëri, si zakonisht në vende të tjera, migrimi veçanërisht përfshin të rinjtë, të cilët migrojnë për arsye punësimi, mundësi arsimimi dhe për arsye familjare.



Emigrimi ishte arsyeja kryesore për rënien e popullsisë në Shqipëri para vitit 2001 dhe në periudhën 2001-2011. Zhdukja e barrierave ndaj emigracionit dhe trazirave sociale në vitet 1990 krijoi valë të njëpasnjëshme të emigracionit në këto vite. Disa qindra mijëra shqiptarë u larguan nga vendi (Carletto et al. 2006), një humbje që nuk u kompensua nga imigracioni dhe rritja natyrore. Ky emigrim masiv ishte shkaku kryesor i ndryshimit të popullsisë nga një rritje e lartë vjetore e popullsisë në periudhën e censeve 1979-1989 prej 2.0 përqind, me një rritje negative (-0.3 për qind në vit) në periudhën pasuese të censeve 1989-2001. Në terma absolutë, rritja e popullsisë prej pothuajse 600 mijë personave që u vëzhgua në periudhën midis censeve para vitit 1989 u shndërrua në një rënie prej më shumë se 100 mijë në atë pas vitit 1989. Censi i vitit 2011 përfundimisht tregoi se emigrimi ishte faktori më i rëndësishëm në humbjen neto të popullsisë prej 269 mijë personave në periudhën 2001-2011, duke përbërë 8.8 përqind të popullsisë së vitit 2001. Sipas vlerësimeve indirekte të INSTAT-it, gjatë kësaj periudhe rreth 482 mijë shqiptarë u larguan nga vendi, një numër që u kompensua pjesërisht nga imigracioni dhe rritja natyrore.

Vazhdimi i ritmeve të larta të emigracionit lidhet edhe me ndryshimin e karakteristikave të emigracionit shqiptar. Gjatë viteve 1990 migrimi u dominua nga burrat e rinj të cilët kërkonin punë jashtë vendit në një kohë kur Shqipëria ishte në trazirë. Në dekadën e parë të këtij mijëvjeçari, migrimi duket të jetë i larmishëm: migrimi është ende i dominuar nga të rriturit e rinj, por përveç burrave, janë edhe gratë ato që zgjedhit të largohen jashtë vendit.

#### 4.1 Impakti në dinamikën e popullsisë

Pas Censit të vitit 2011, migracioni vazhdon të luajë një rol shumë të rëndësishëm në dinamikën e popullsisë. Shqipëria vazhdon dhe do të vazhdojë të përjetojë flukse dalëse të popullsisë, ashtu sikurse projeksionet e popullsisë sugjerojnë. Në këtë mënyrë popullsia e Shqipërisë po shkon drejt procesit të plakjes si pasojë e uljes së lindshmërisë dhe rritjes së jetëgjatësisë dhe për më tepër emigracionit i cili vazhdon të mbetet veprues dhe që përfshin një popullsi relativisht të re.



Në vitin 2017, në popullsinë mesatare gjithsej të Shqipërisë, të rinjtë 0-14 vjeç zënë 17,9 %, popullsia në moshë pune 15-64 vjeç zë 68,7 % dhe popullsia mbi 65 vjeç përbën 13,4 % të popullsisë gjithsej. Piramida e popullsisë, e cila jep një



paraqitje të strukturës moshore dhe gjinore të popullsisë, pasqyron trendin e zhvillimeve që kanë ndodhur për grupmoshat në fjalë. Tendenca drejt procesit të plakjes së popullsisë në të ardhmen vihet re nga rritja e lehtë e përpjesës që zë popullsia 65 vjeç e lart, shoqëruar kjo me uljen e numrit të popullsisë në moshë të re (0-14 vjeç). Sic shihet qartë emigracioni involvon një popullsi relativisht të re dhe në moshë pune dhe kjo vihet re për të dy gjinitë. Ndryshe nga vite më parë ku emigracioni dominohej nga meshkuj të rinj të cilët emigronin së shumti për arsye punësimi, dekadën e fundit emigracioni shiptar ka marrë një tjetër trajtë – vihet re tendenca e emigracionit familjar – bashkimet familjare. Janë edhe gratë ato që tashmë së bashku me fëmijët ndjekin bashkëshortin në vendin e destinacionit.


Raportet e varësisë, janë indikatorë që mbështetin faktin që emigracioni shiptar ka një ndikim në povesin e plakjes së popullsisë. Ato llogariten duke krahasuar numrin e personave (të rinjtë 0-14 vjeç dhe/ose të moshuarit 65+ vjeç) me popullsinë në moshë pune.

Vlerat e tyre ndër vite tregojnë për një rënie të raportit të varësisë së të rinjve dhe për një rritje të atij të të moshuarve. Për vitin 2017 raporti i varësisë së të moshuarve në Shqipëri është 19,4 %, nga ana tjetër, raporti i varësisë së të rinjve në vitin 2017 është 26,0 %.



Emigracioni shiptar ka qenë emigracion i dominuar nga faktorë shtytës ekonomik. Kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë arsyet ekonomike ato që shtyjnë pjesën më të madhe të shqiptarëve të largohen nga vendi. Sipas anketës së Forcës së Punës, 2017, arsyeja kryesore e largimit nga Shqipëria është “Mundësi punësimi”- 84,0 %.

## Numri i shqiptarëve nëpër botë 2017



### Legjenda

Numri i shqiptarëve nëpër botë (persona)

1 - 1250
1251 - 2500
2501 - 7000
7001 - 30000
30001 - 90000
90001 - 455468
Vlera zero

Burimi:

The United Nations Department of Economic and Social Affairs (UN DESA)  
Geographic Information System of the Commission (GISCO), përshtatur nga INSTAT

## 5. Referenca

Nagi, Dennis L. The Albania-American Odyssey. A Pilot Study of the Albanian Community of Boston, Massachusetts, New York: AMS Press, 1988.

The Albanian Community in the United States, Statistical Profiling of the Albanian-Americans\*, Ljubica Nedelkoska, Nick Khaë

Migracioni në Shqipëri, 2014

Dinamikat e Popullsisë, Horizonte të reja, 2014

Ministri i Shtetit Për Diasporën- <http://www.diaspora.gov.al/diaspora-e-vjeter-shqiptare-ne-bote-2/>

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

### **Burime statistikore**

<https://ec.europa.eu/eurostat/ëeb/population-and-housing-census/census-data/2011-census>

<http://www.un.org/en/development/desa/population/migration/index.shtml>

<https://www.istat.it/en/archive/migrations>

[https://www.census.gov/programs-surveys/acs/?sec\\_ak\\_reference=18.ce2c1ab8.1543216905.402494](https://www.census.gov/programs-surveys/acs/?sec_ak_reference=18.ce2c1ab8.1543216905.402494)